



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1355/4 prot

Datë 03.07.2023

V E N D I M
Nr.551/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.07.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-65733-04-12-2023, me objekt: “Blerje mallra ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme”, me fond limit 9,808,512.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Ankimues: “Nelsa” SHPK
Lagjja Qesarakë, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr. Pasurie 199/32, Hyrja 1, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh
Bulevardi “10 korriku”, Gramsh

Subjekte të Interesuara: “4 S” SHPK
Lushnje Fier, Lushnje, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.04.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-65733-04-12-2023, me objekt: “Blerje mallra ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme”, me fond limit 9,808,512.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

II.2. Në datën 10.05.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 31.05.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. “3 - SH” SHPK	5 837 258	lekë	skualifikuar
------------------	-----------	------	--------------

2. “4 S” SHPK	8 996 800	lekë	kualifikuar
3. “Nelsa” SHPK	9 578 200	lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 08.06.2023 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 14.06.2023 operatori ekonomik “Nelsa” SHPK nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, ka paraqitur ankesë njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me numër ankimi elektronik A/2023/3178 dhe me nr. 1355/2023 prot., datë 14.06.2023 me objekt kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1355/2 prot., datë 15.06.2023 referuar kritereve të cilat operatori ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “4 S” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 2148/1 prot., datë 26.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1355/3 prot., datë 29.06.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton se:

Në nenin Neni 111 të LPP parashikohet se “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik” Neni 112 i LPP parashikon se “Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni” VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon se :

Neni 94/1 parashikon se “Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në

kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Neni 94/2 “Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Neni 96 “Veprimet paraprake të autoritetit entit kontraktor”

1. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.

Neni 100/1 “Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti entit kontraktor. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti entit kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, konstatohet se:

Lidhur me pikën e parë të ankesës, ankuesi pretendon se operatori ekonomik “4S” nuk ka vërtetuar deklaratimet e bëra në “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi verifikoi “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” si dhe dokumentet provuese të dorëzuara pranë Autoritetit Kontraktor (KVO-së) konstatoi se : Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori Ekonomik “4S” ShPK, ka deklaruar :

1. “Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Nga verifikimi elektronik në websitin e-albania.al rezulton nga ekstrakti se ky OE ka statusin “Aktiv”, por nuk e ka dorëzuar dokumentacionin fizik pranë AK në formën e kërkuar nga ligji.

2. Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 7611 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Këtë e provon me dokumentin “Vërtetim nr.11 prot. datë 17.02.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, kopje e noterizuar, vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnjë, datë 27.03.2023, vërtetim nr.508 datë 27.03.2023 nga Gjykata e shkallës së parë Lushnjë, kopje noterizuar.

3. Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Administratori Xhino Sinani

nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 7641 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Këtë e provon me dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore nr.15 prot datë 29.05.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve , kopje e noterizuar, vërtetim datë 27.03.2023 lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnjë, vërtetim nr.508 datë 27.03.2023 nga Gjykata e shkallës së parë Lushnjë, kopje noterizuar.

4.Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. Këtë e provon me dokumentin “Vërtetim” nr.11 prot. datë 17.02.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, kopje e noterizuar,

5. Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë AK Bashkia Gramsh, rezulton se nuk është dorëzuar Ekstrakti i regjistrimit tregtar apo Certifikata e regjistrimit e lëshuar nga QKB ku të provohet nëse ky OE nuk është në proces falimentimi. Nga verifikimi elektronik në websitin e-albania.al rezulton nga ekstrakti se ky OE ka statusin “Aktiv”, por nuk e ka dorëzuar dokumentacionin fizik pranë AK në formën e kërkuar nga ligji.

Për këtë dokument, pretendimi i ankuesit qëndron.

6. Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Këtë e provon me dokumentin “Vërtetim debie” lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a në datë 02.05.2023 në Tiranë.

7. Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Këtë e provon me këto dokumente:

- Vërtetim nr. T08195491 lëshuar në datë 25.04.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.

-Vërtetim nr. T08195496 lëshuar në datë 25.04.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.

-Vërtetim për likuidimin e detyrimeve vjetore, lëshuar ne Tiranë datë 18.04.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Operacionale dhe

Teknike, Bashkia Tiranë.

-Vërtetim me nr. 3131/2 prot. në Lushnjë datë 12.04.2023 lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Lushnjë.

8. Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Këtë e provon Buletini Nr. 51 datë 5 Qershor 2023 lëshuar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

9.Operatori ekonomik deklaron se ka nën përgjegjësinë e tij të plotë punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin e ka paraqitur në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fiton, ose nëse i kërkohen sqarime nga autoriteti enti kontraktor.

Për punonjësit këtë e vërteton me dokumentin “Vërtetim (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin -E-SIG 02/a), Nr.T08195491 lëshuar në datë,25.04.2023 nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.

Për mjetin këtë e vërteton me dokumentet përkatëse:

-Certifikata e Pronësisë së Mjetit Rrugor me targa AB 492 EU lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

-Leje Qarkullimi e Mjetit me targa AB 492 EU.

-Taksa Vjetore e Mjeteve lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor datë 21.10.2023.

- Policë për Sigurimin e Detyrueshëm të Mbajtësve të Mjeteve Motorike për Përgjegjësinë Ndaj Palëve të Treta lëshuar në datë 17.10.2022 nga INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP.

- Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore lëshuar nga DPSHTRR Kontrolli Teknik.

Për sa më sipër , pretendimi i ankuesit për pikën e parë qëndron pjesërisht.

Nga ana e KSHA-së pas verifikimit të bërë u konstatua se operatori ekonomik “4 S” ka vërtetuar me dokumentacionin përkatës deklaratimet e bëra në “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” (shtojca 8).

Lidhur me pikën e dytë të ankesës, ankuesi pretendon se operatori ekonomik “4 S” nuk ka dorëzuar raport analizat që specifikojnë të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Komisioni i Shqyrtimit të ankesës pasi verifikoi “ Formularin e specifikimeve teknike” si dhe dokumentet provuese të dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor (KVO-së) konstatoi se: Në dokumentet standarde të tenderit në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar Pika :2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport-analiza origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për artikujt që prokurohen. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” është kërkuar:

“Operatori ekonomik i shpallur fitues dhe që lidh kontratën, gjatë lëvrimin të mallrave objekt prokurimi duhet të dorëzojë pranë strukturës së monitorimit të kontratës , raport analizat origjinale ose të noterizuara të lëshuara nga laborator të autorizuar të kontrollit, certifikatën e origjinës si dhe të plotësojë të gjitha standardet e kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi”.

Operatori ekonomik “ 4 S” ShPK, nuk ka dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin fizik, konkretisht raport-analizat për artikujt: Vezë, fasule. kos. Gjithashtu, rezulton treguesit e paraqitur sipas fletë analizave për djathin dhe qumështin nuk përputhen me kriteret e përcaktuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike .

Pavarësisht paqartësive në hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës arsyeton se për këtë dokument, pretendimi i ankuesit qëndron.

Sa u analizua më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave:

VENDOSI

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “NELSA” ShPK, për procedurën “E hapur e thjeshtuar ”, me objekt: “ Blerje mallra ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme”, me nr. REF-65733-04-12-2023, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 10.05.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.*
- 2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të skualifikojë operatorin ekonomik “4 S” ShPK.*
- 3. Personi Përgjegjës për Prokurimet të njoftojë ankuesin, Komisionin e Prokurimit Publik dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave lidhur me këtë vendim.*
- 4. Personi Përgjegjës për prokurimet të vërë në dijeni Kryetarin e Bashkisë lidhur me këtë vendim të komisionit.”*

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “4 S” SHPK **nuk ka** dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Nelsa” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 2148/1 prot., datë 26.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1355/3 prot., datë 29.06.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi pjesërisht i ankesës.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton se:

Në nenin Neni 111 të LPP parashikohet se “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik” Neni 112 i LPP parashikon se “Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni” VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon se :

Neni 94/1 parashikon se “Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Neni 94/2 “Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Neni 96 “Veprimet paraprake të autoritetit entit kontraktor”

1. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.

Neni 100/1 “Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti entit kontraktor Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti entit kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit,

deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, konstatohet se:

Lidhur me pikën e parë të ankesës, ankuesi pretendon se operatori ekonomik "4S" nuk ka vërtetuar deklaratimet e bëra në "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit". Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës pasi verifikoi "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit" si dhe dokumentet provuese të dorëzuara pranë Autoritetit Kontraktor (KVO-së) konstatoi se : Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori Ekonomik "4 S" ShPK, ka deklaruar :

1. "Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Nga verifikimi elektronik në websitin e-albania.al rezulton nga ekstrakti se ky OE ka statusin "Aktiv", por nuk e ka dorëzuar dokumentacionin fizik pranë AK në formën e kërkuar nga ligji.

2. Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 7611 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Këtë e provon me dokumentin "Vërtetim nr.11 prot. datë 17.02.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, kopje e noterizuar, vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnjë, datë 27.03.2023, vërtetim nr.508 datë 27.03.2023 nga Gjykata e shkallës së parë Lushnjë, kopje noteruar.

3. Personi/personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Administratori Xhino Sinani

nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 7641 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Këtë e provon me dokumentin "Vërtetim i gjendjes gjyqësore nr.15 prot datë 29.05.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve , kopje e noterizuar, vërtetim datë 27.03.2023 lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lushnjë, vërtetim nr.508 datë 27.03.2023 nga Gjykata e shkallës së parë Lushnjë, kopje noterizuar.

- 4.Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që

lidhen me veprimtarinë profesionale. Këtë e provon me dokumentin “Vërtetim” nr.11 prot. datë 17.02.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, kopje e noterizuar,

5. Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë AK Bashkia Gramsh, rezulton se nuk është dorëzuar Ekstrakti i regjistrimit tregtar apo Certifikata e regjistrimit e lëshuar nga QKB ku të provohet nëse ky OE nuk është në proces falimentimi. Nga verifikimi elektronik në websitin e-albania.al rezulton nga ekstrakti se ky OE ka statusin “Aktiv”, por nuk e ka dorëzuar dokumentacionin fizik pranë AK në formën e kërkuar nga ligji.

Për këtë dokument, pretendimi i ankuesit qëndron.

6. Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Këtë e provon me dokumentin “Vërtetim debie” lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a në datë 02.05.2023 në Tiranë.

7. Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Këtë e provon me këto dokumente:

- Vërtetim nr. T08195491 lëshuar në datë 25.04.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.

-Vërtetim nr. T08195496 lëshuar në datë 25.04.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.

-Vërtetim për likuidimin e detyrimeve vjetore, lëshuar në Tiranë datë 18.04.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Operacionale dhe

Teknike, Bashkia Tiranë.

-Vërtetim me nr. 3131/2 prot. në Lushnjë datë 12.04.2023 lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Lushnjë.

8. Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Këtë e provon Buletini Nr. 51 datë 5 Qershor 2023 lëshuar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

9.Operatori ekonomik deklaron se ka nën përgjegjësinë e tij të plotë punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin e ka paraqitur në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fiton, ose nëse i kërkohen sqarime nga autoriteti enti kontraktor.

Për punonjësit këtë e vërteton me dokumentin “Vërtetim (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin -E-SIG 02/a), Nr.T08195491 lëshuar në datë,25.04.2023 nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier.

Për mjetin këtë e vërteton me dokumentet përkatëse:

-Certifikata e Pronësisë së Mjetit Rrugor me targa AB 492 EU lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

-Leje Qarkullimi e Mjetit me targa AB 492 EU.

-Taksa Vjetore e Mjeteve lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor datë 21.10.2023.

- Policë për Sigurimin e Detyrueshëm të Mbajtësve të Mjeteve Motorike për Përgjegjësinë Ndaj Palëve të Treta lëshuar në datë 17.10.2022 nga INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP.

- Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore lëshuar nga DPSHTRR Kontrolli Teknik.

Për sa më sipër , pretendimi i ankuesit për pikën e parë qëndron pjesërisht.

Nga ana e KSHA-së pas verifikimit të bërë u konstatua se operatori ekonomik “4 S” ka vërtetuar me dokumentacionin përkatës deklaratimet e bëra në “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” (shtojca 8).

Lidhur me pikën e dytë të ankesës, ankuesi pretendon se operatori ekonomik “AS” nuk ka dorëzuar raport analizat që specifikojnë të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 5 “Formulari I specifikimeve teknike”.

Komisioni i Shqyrtimit të ankesës pasi verifikoi “ Formularin e specifikimeve teknike” si dhe dokumentet provuese të dorëzuara pranë Autoritetit Kontraktor (KVO-së) konstatoi se: Në dokumentet standarde të tenderit në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar Pika :2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport-analiza origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës për artikujt që prokurohen. Në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” është kërkuar:

“Operatori ekonomik i shpallur fitues dhe që lidh kontratën, gjatë lëvrimit të mallrave objekt prokurimi duhet të dorëzojë pranë strukturës së monitorimit të kontratës , raport analizat origjinale ose të noterizuara të lëshuara nga laborator të autorizuar të kontrollit, certifikatën

e origjinës si dhe të plotësojë të gjitha standardet e kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi”.

Operatori ekonomik “4 S” ShPK, nuk ka dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) dhe nuk ka dorëzuar dokumentacionin fizik, konkretisht raport-analizat për artikujt: Vezë, fasule.kos. Gjithashtu, rezulton treguesit e paraqitur sipas fletë analizave për djathin dhe qumështin nuk përputhen me kriteret e përcaktuara në shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike .

Pavarësisht paqartësive në hartimin e kriterëve dhe specifikimeve teknike Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës arsyeton se për këtë dokument, pretendimi i ankuesit qëndron.

Sa u analizua më sipër Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave:

VENDOSI

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “NELSA” ShPK, për procedurën “E hapur e thjeshtuar”, me objekt: “Blerje mallra ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme”, me nr. REF-65733-04-12-2023, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 10.05.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të skualifikojë operatorin ekonomik “4 S” ShPK.
3. Personi Përgjegjës për Prokurimet të njoftojë ankuesin, Komisionin e Prokurimit Publik dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave lidhur me këtë vendim.
4. Personi Përgjegjës për prokurimet të vërë në dijeni Kryetarin e Bashkisë lidhur me këtë vendim të komisionit.”

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

- a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:
 - i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;
 - ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
- b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
- c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. *Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “4 S” nuk ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 pika a/ii të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.5. Sa më sipër, në kushtet kur autoriteti kontraktor ka pranuar një pjesë të pretendimeve të palës ankimuese, KPP gjykon, se pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “4 S” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-65733-04-12-2023, me objekt: “Blerje mallra ushqimore për plotësimin e nevojave të çerdheve, kopshteve dhe konviktit të shkollës së mesme”, me fond limit 9,808,512.00 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 10.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “4 S” SHPK sipas vendimmarjes së dërguar në KPP me shkresën nr. 2148/1 prot., datë 26.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1355/3 prot., datë 29.06.2023.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

